



KOMISIONI RREGULLATOR I ENERGETIKËS DHE I SHËRBIMEVE TË UJIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT



NJOFTIM PËR OPINIONIN

Sot para Komisionit Rregullator të Energjetikës dhe të Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut u mbajt protestë nga partia politike VMRO-DPMNE, ku përfaqësuesit e tyre dërguan kërkesë me shkrim deri te KRRE-ja.

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut (KRRE) e arkivoi kërkesën me procedurë standarde sikurse edhe për të gjithë personat fizikë dhe juridikë. Për shkak të gjendjes me pandeminë dhe mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve dhe të punësuarve, KRRE-ja që nga marsi i vitit 2020, vendosi protokoll të punës, në të cilin, përveç tjerash, shkresat dërgohen në kuti të izoluar në hyrje të KRRE-së. Sa i përket kërkesës së dërguar, është vepruar sipas protokolleve të vendosura. Shëndeti i qytetarëve dhe siguria e të punësuarve në kohë pandemie është parakusht kryesor për funksionimin e institucionit dhe për këtë shkak trajtimi i kërkesës së sotme nga VMRO-DPMNE-ja është i njëjtë sikurse edhe për të gjithë personat e tjerë fizikë dhe juridikë, të cilët i drejtohen KRRE-së.

Komisioni Rregullator i Energjetikës dhe i Shërbimeve të Ujit të Republikës së Maqedonisë së Veriut njofton opinionin se pavarësisht presioneve nga protestat politike, vazhdon të punojë në mënyrë të përkushtuar dhe me kapacitet të plotë duke u udhëhequr nga parimet e transparencës dhe përgjegjësisë dhe do t'i qëndrojë besnik parimit të tij të pavarësisë të vërtetuar nga Komuniteti Europian i Energjisë.

Analizën e vendosim në dispozicion të opinionit dhe i riafirmojmë përfundimet e marra nga Komuniteti Europian i Energjisë, me të cilat KRRE ka marrë mendim pozitiv për të fituar statusin e mbikëqyrësit në Agjencinë e Bashkëpunimit të Rregullatorëve Energjetikë (ACER -Agency for the Cooperation of Energy Regulators) pasi i ka plotësuar detyrimet dhe kushtet nga Paketa e Tretë Energjetike.

Në analizën e dërguar nga Komuniteti Europian i Energjisë deri te ACER, ceket:

“KRRE-ja e ka dëshmuar kapacitetin dhe përkushtimin drejt zhvillimit të rregullave rregullatore me cilësi të lartë edhe përkaj presioneve nga palët e interesuara, **ka dëshmuar pavarësi të plotë në proceset** dhe e ka përdorur statusin e saj të pavarur, të dhënë në përputhje me ligjin. **Rregullatori ka dëshmuar gatishmëri dhe aftësi për t'iu kundërvënë ndikimeve potenciale mbi pavarësinë që i garantohet sipas ligjit dhe për ta mbrojtur pavarësinë e tij. KRRE-ja ka treguar ekspertizë më të lartë, standarde dhe përkushtim për zhvillim me kohë të rregullave rregullatore siç kërkohet me Ligjin e Energjetikës dhe ka vendosur model të avancuar të tregut me shkallë të lartë të orientimit të tregut.** Sipas kësaj, përgatitja e akteve rregullatore në sektorin e energjisë elektrike mund të konsiderohet si e kryer”, qëndron në analizën e Komunitetit Europian të Energjisë.

